



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 191 Prot.

Tiranë, më datë 13.03.2025

VENDIM

Nr. 174, datë 13.03.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 13.03.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e relacionit të “Verifikimit në terren në kuadër të gjetjeve rastësore në bashkinë e Vaut të Dejës”, hartuar nga Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik në IKTK në bashkëpunim me DRTK Shkodër;
2. Të realizohet gërmimi arkeologjik i shpëtimit në zonën ku janë identifikuar strukturat funerare, të cilat janë të zbuluara në profilin e rrugës, nga DSHA në bashkëpunim me DRTK Shkodër;
3. Rezultati i gërmimit arkeologjik dhe dokumentimit të strukturave funerare të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
6. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Johi MITROJORGJI

Konceptoi: M. Seiti
Kontrolloi: R. Guri
Pranoi: I. Papa

